



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA			
Njësia:		Nr. Prot.:	
Unit:	ZK	Prot. No.:	58/2020
Jednica:		Br. Prot.:	
Nr. i faqeve:		Data:	
No. of pages:	-01-	Data:	03.03.2020
Br. shtabice:		Datum:	
			Prishtinë

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NJOFTIM

03 mars 2020
Prishtinë

Me datë 1 maj 2019, ka hyrë në fuqi Vendimi për përdorimin obligativ të faksimileve, të lëshuar nga OMK për të gjithë anëtarët e Odës. Sipas vendimit, çdo përdorim i faksimileve tjera të prodhuara apo punuara individualisht dhe të përdorura nga anëtarët e OMK-së apo mjekë ende të pa anëtarësuar, është në kundërshtim me aktet juridike të OMK-së, si dhe është vepër penale sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Kuvendi i Odës së Mjekëve të Kosovës, me datë 17 dhjetor 2019, ka mbajtur mbledhjen e rregullt ku janë shqyrtuar propozim amandamentet e akteve juridike të Odës. Në kuadër të këtij takimi janë miratuar propozim amandamentet e Rregullores për Regjistrimin, Licencimin dhe Rilicencimin e mjekëve, ku ndër të tjera është amandamentuar Neni 24 i Rregullorës që parasheh përmbajtjen e faksimilit. Në këtë rast Kuvendi ka aprovuar që në faksimil të shtohen edhe gradat shkencore dhe thirrjet akademike për ata që posedojnë atë, të cilat korrespondojnë me specializimin përkatës.

Andaj njoftohen të gjithë të interesuarit për t'u pajisur me faksimil që përmban thirrje shkencore apo akademike, aprovimi i thirrjes shkencore apo akademike nga OMK do të bëhet sipas specializimit përkatës.

Kryetari i OMK-së
Dr. Pleurat Sejdiu, mr.Sc.

